

**STATUT**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“ EXCHANGE ECT 2020” SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 17.9.2020, në respektim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe aktin e themelimit, me cilësinë e “ortakut të vetëm” themelues të shoqërisë “EXCHANGE ECT 2020” shpk, Ardjana Gjini, atësia Nikoll, e datëlindjes 24.6.1991, lindur në Vau Dejës, Shkodër dhe banuese në Tiranë, Rruga “Jordan Misja”, Njësia Administrative nr. 9, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J15624081P, hartoj këtë statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “EXCHANGE ECT 2020” shpk.

**KREU I**

**Neni 1**  
**Emërtimi**

Shoqëria emërtohet “EXCHANGE ECT 2020” shpk, ajo është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (e cila këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”).

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.

Shoqëria “EXCHANGE ECT 2020” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i vetëm”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

**Neni 3**  
**Selia**

Shoqëria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën: Rruga “Gjik Kuqali”, Pallati Nr. 7/1, Apartamenti Nr. 1, Njësia Administrative nr. 5. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 4**  
**Objekti**

1. Shoqëria do të ketë për objekt kryesor të veprimtarisë së saj:



- a) Këmbim valutor;
  - b) Shërbime financiare;
  - c) Transferime parash;
  - d) Ushtrimi i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo-bankë.
  - e) Shërbim agjenci imobiliare.
2. Për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të ndërmarrë e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime të ligjshme.
  3. Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet ose zvogëlohet në varësi të interesave të shoqërisë dhe në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

## **Neni 5**

### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

## **KREU II**

### **KAPITALI**

## **Neni 6**

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 500 100 (dy milion e pesëqind mijë e njëqind) lekë.  
Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga "ortaku i vetëm" i shoqërisë:

**Znj. Ardjana GJINI**, është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 2 500 100 (dy milion e pesëqind mijë e njëqind) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)  
Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## **Neni 7**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.
2. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
3. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet QKB-së nga administratori, në përputhje me nenin 43



të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

## **Neni 8**

### **Transferimi i kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në QKB, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar.
4. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
5. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU II**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

## **Neni 9**

### **Organi Vendimmarrës**

1. Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.
2. Ortaku i vetëm, vendos për çështje si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve;
  - f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
  - g) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.



3. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **Neni 10**

### **Administrimi**

#### **Administrator i shoqërisë është znj. Ardjana Gjini.**

Administratori i Shoqërisë ushtron kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

## **Neni 11**

### **Kompetencat e administratorit**


1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet si më poshtë:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) të përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga ortaku i vetëm i Shoqërisë;
  - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - f) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
  - g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
  - h) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që



- aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, bankave të të gjitha niveleve, zyra të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshirë këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.
4. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## **Neni 12** **Përgjegjësitë**

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
  - f) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
  - g) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas



pikave 1 e 2 të nenit 98 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.

### **Neni 13 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 14 Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 15 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **Neni 16**



## **Dividendi**

Të ardhurat neto ( Dividendi) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

### **Neni 17 Prishja e Shoqërisë**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
  - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
  - d) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
  - e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
  - f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
  - g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë nen, do të zbatohen dispozitat e nenit 187 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

### **Neni 18 Administrimi nga likuiduesit**

1. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
2. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
3. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.
4. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

### **Neni 19 Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.



3. Nëse, në bazë të padiëve të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 195 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
4. Nëse, në bazë të padiëve të ngritura nga kreditorët, ose, në bazë të pretendimeve të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 195 të këtij ligji, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
5. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### **Neni 20** **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton QKB-në për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

#### **Neni 21** **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me kriim i një shoqërie të re.

#### **Neni 22** **Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.



3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë QKB-së ka si pasojë:
  - a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
  - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
  - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga QKB sipas legjislacionit në fuqi, pa kryerjen e likuidimit.

### **Neni 23 Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

### **Neni 24 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat ligjore në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 25 Mosmarrëveshjet**

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor nën juridiksionin e së cilit shtrihet aktiviteti i shoqërisë.

### **Neni 26 Dispozita përfundimtare**

Ky Statut i shoqërisë "EXCHANGE ECT 2020" shpk, u redaktua me vullnetin e lirë e të plotë të "ortakut themelues" në 3 (tre) kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe.

**ORTAKU I VETËM  
Ardjana GJINI**

*Ardjana Gjini*  
*AG*